



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 25.03.2025
Numër Protokolli: 1999/2025

A.nr.399/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.399/2025 të datës 28.02.2025 të parashtruar nga ankuesi A.RR, kundër organit të punësimit Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.03.2025 mori:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.399/2025 të datës 28.02.2025 të parashtruar nga ankuesi A.RR.

A r s y e t i m

Ankuesi A.RR (tani e tutje vetëm *ankuesi*), më datë 28.02.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me Konkursin me numër reference RN00016799 për pozitën Zyrtar për Burime Njerëzore në Prishtinë të shpallur nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, me pretendimin ankimor se nuk ka të drejtë aplikimi në këtë konkurs pasi që të drejtë aplikimi kanë vetëm kandidatët e gjinisë femërore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 12.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, më datë 20.02.2025 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00016799 me emrin e grupit, grupi i Burimeve Njerëzore për pozitën Zyrtar për Burime Njerëzore në Prishtinë klasa e pozitës profesional 2, ku afati për aplikim ka qenë nga data 21.02.2025 deri më 22.03.2025.

Ndërsa sipas përgjigjes në ankesë të organit të punësimit në këtë rast Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, deklarojnë se: *Ankuesi A. Rr. nuk ka aplikuar në konkursin me numër të referencës RN00016799 të datës 20.02.2025 për pozitën Zyrtar për Burime Njerëzore andaj nuk ka dosje aplikimi.*

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje juridike administrative, ju referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht:

-Nenit 7, paragrafi 1: *“1. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese”;*

-Nenit 27 paragrafi 4 : *”4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil”:*

-Nenit 44 paragrafi 10: *“10. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.”.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe dispozitat e nenit 17 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”.*

Andaj, referuar kuadrit ligjor të përshkruar si më lartë si dhe duke u mbështetur në provat e lëndës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi nuk ka qenë kandidatë për pranim në konkursin e cekur si më lartë, pasi që i njëjti lidhur me procedurën e pranimit me numër të referencës RN00016799, nuk ka ofruar asnjë dëshmi që provon faktin e aplikimit apo dëshmi që i njëjti ka statusin aktiv të nëpunësit civil, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka kompetencë lëndore për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën A.nr.399/2025 të datës 28.02.2025, sepse Këshilli vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, e në rastin konkret, siç edhe u theksua më lartë ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil dhe as statusin e kandidatit aplikuesë në procedurën përkatëse të punësimit.

Andaj bazuar si më lartë, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.399/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.RR;
- Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.